

VENDIM
Nr. 340, datë 23.5.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 332, DATË 17.3.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, ELEMENTEVE PËRBËRËSE, MËNYRËS SË
MBAJTJES E AFATIT TË PËRDORIMIT TË DOKUMENTEVE BAZË, QË MBAHEN DHE
LËSHOHEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 25 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Forma dhe elementet përbërëse të dokumenteve që plotëson, mban dhe lëshon Shërbimi i Gjendjes Civile, të përcaktuara në modelet në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 332, datë 17.3.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen dhe bëhen sipas modeleve në lidhjen nr. 1 që i bashkëlidhen këtij vendimi, përkatësisht:

- a) Mod. nr.1: Akt lindjeje;
- b) Mod. nr.2: Akt martese;
- c) Mod. nr.3: Akt vdekjeje;
- ç) Mod. nr.4: Procesverbal për ndryshim emri/mbiemri;
- d) Mod. nr.5: Procesverbal për bashkim familjeje;
- dh) Mod. nr.6: Procesverbal për veçim familjeje;
- e) Mod. nr.7: Procesverbal për njohje atësie;
- ë) Mod. nr.8: Shpallje martese;
- f) Mod. nr.9: Vendim për pezullimin e procedurës për lidhje martese;
- g) Mod. nr. 10: Vendim për refuzim për lidhje martese;
- gj) Mod. nr.11: Vendim për ndreqje gabimi material;
- h) Mod. nr.12: Leje varrimi;
- i) Mod. nr.13: “Certifikatë familjare” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna;
- j) Mod. nr.13/1: “Certifikatë familjare” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut;
- k) Mod. nr.14: “Certifikatë personale” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna;
- l) Mod. nr.14/1: “Certifikatë lindjeje” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna;
- ll) Mod. nr.14/2: “Certifikatë martese” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna;
- m) Mod. nr.14/3: “Certifikatë vdekjeje” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna;
- n) Mod. nr.14/4: “Certifikatë lindjeje” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut;
- nj) Mod. nr. 14/5: “Certifikatë martese” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut;
- o) Mod. nr.14/6 : “Certifikatë vdekjeje” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut;
- p) Mod. nr.14/7: “Certifikatë lindjeje” “për përdorim nga autoritetet e huaja” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna/degët e qarkut;
- q) Mod. nr.14/8: “Certifikatë për lidhje martese” “për përdorim nga autoritetet e huaja” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna.
- r) Mod. nr.14/9: “Certifikatë martese” “për përdorim nga autoritetet e huaja” që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna/degët e qarkut.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.6.2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha